



1385
05-10-2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË SË UST

Tiranë, më 04.10.2018

Drejtuar: Rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës

Prof. Dr. Agron CUKA

Lënda : Raporti i Punës për Muajin Shtator i NJSBC-së pranë UST.

R A P O R T

Gjatë muajit Shtator 2018 Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së UST (NJSBC), e përbërë nga:

Prof. Dhimitraq Stratobërdha Kryetar

Dr. Mirjeta Cenaj Anëtar

Doc. Anduela Lile Anëtar

në përputhje me detyrat, që u ngarkon Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore të lidhura me punën e NJSBC –ve pranë IAL (UST), bazuar në Plan Veprimin për vitin 2018 ka vazhduar punën për të marrë informacione nga njësitë kryesore, administrata e UST si pjesë e dokumentacionit të kësaj njësie në përputhje me ligjin e aktet e tjera nënligjore.

Kemi hyrë në fazën e dytë të vlersimeve, që është edhe më e rëndësishmja e që duhet tu përgjigjet standardeve ku do të arrijë cdo IAL.

Konkretisht bazuar në plan veprimin tone para sezonit të provimeve perfundimtare te vitit akademik 2017-2018 u përgatit një pyetsor për studentët e UST për të tërhequr mendimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programeve të studimit.

On line dhe me pyetsore në auditorë u realizuan gjithësej si UST një numer I konsiderueshëm, gjithësej 232 studentë. nga këto 102 nga FVFR dhe 130 nga FSHL.

Gjatë muajit Shtator u rifillua përpunimi i të dhënave që do shërbejnë për një raport të detajuar mbi problematikën që ka në institucionin tone në lidhje me cilësinë e mësimdhënies. Paraprakisht në përpunimet paraprake ka një perceptim dhe pershtypje positive e të kenaqshme të studenteve për nivelin e programeve dhe implementimin e tyre nga pedagoget.

Ky raport është përgatitur sipas pikes 5 të Vendimit nr. 9 më datë 02.03.2018 të Bordit të Administrimit të UST, në mënyrë që të kryhet pagesa mujore për të tre anëtarët e NJSBC.

Kryetari I NJSBC

Prof. Dr. Dhimitraq Stratobërdha